

**AKT-THEMELIMI
I SHOQËRISE TREGTARE ME PËRGJEGJËSI TË
KUFIZUAR "The Clinic" sh.p.k**

Ortakët e shoqërisë "The Clinic" shpk janë si më poshtë:

I. Znj. Migena Qato, e lindur në Lushnje, në datë 01.06.1982 dhe banues në adresën: Tirane, Kodra e Diellit, Rruga.Rrapo Hekali, ap. 2, e identifikuar me ID nr. I25601148D, lëshuar në datë 30.09.2019, person madhor dhe me zotësi të plotë juridike për të vepruar, DHE

II. Znj. Esta Kokla, e lindur në Gramsh, në datë 01.09.1998 dhe banuese në adresën: Tirane, Rruga Bujar Kaloshi, nd.13, h.1, e identifikuar me ID nr. J85901023F, lëshuar në datë 04.01.2018, person madhor dhe me zotësi të plotë juridike për të vepruar, shprehin dëshiren sipas kërkesave të ligjit nr.9901, date 14.04.2008 "Per Shoqerite Tregtare" dhe Ligjit Nr. 9723, date 03.05.2007, "Per Qendren Kombetare te Regjistrimit" QKR , per krijimin e shoqerise me te dhenat e meposhtme:

Neni 1

Të themelojë një shoqëri tregtare me përgjegjësi të kufizuar të quajtur: "The Clinic" shpk. Shoqëria është një subjekt juridik shqiptar, të cilës i lind e drejta të ushtrojë aktivitetin që nga data e regjistrimit në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit të Biznesit (QKB). Shoqëria "The Clinic" shpk zhvillon aktivitetin e saj në përputhje me legjislacionin shqiptar dhe me aktet e themelimit të saj.

Neni 2

Shoqëria do të jetë e formës së Shoqërive tregtare me përgjegjësi të kufizuar dhe përballon humbjet deri në kufirin e vlerës së derdhur në kapitalin themeltar.

Shoqëria "The Clinic" shpk ka selinë e saj në: Tirane, Rruga e Kavajes, Tirana Garden Building, kati 4.

Kohëzgjatja e veprimtarisë së shoqërisë do të jetë pa afat. Ajo mund të shpërbëhet në çdo kohë në përputhje me dispozitat statutoare dhe legjislacionin në fuqi.

Shoqëria ka të drejtë të krijojë Brenda dhe jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë, filiale, agjensi përfaqësimi, seli sekondare, degë, si dhe ti suprimojë ato.



Shoqëria ka gjithashtu të drejtë të krijojë, apo të jetë pjesë e një apo më shumë shoqërive tregtare, pavarësisht nga statusi i tyre juridik, me një pjesëmarrje që do të përcaktohet në çdo rast nga Asambleja e Ortakëve.

Neni 3

Shoqëria do të ushtrojë aktivitetin në fushën e shërbimit:

Shërbime në fushën e estetikës. Konsulta për sëmundjet infektive-venerologjike. Ofrimin e shërbimeve të trajtimit të kujdesit personal përfshirë por pa u kufizuar në trajtime bukurie. Si dhe çdo veprimtari tjetër ekonomike, që do të konsiderohet e nevojshme dhe e dobishme për realizimin e qëllimit të shoqërisë e që nuk bie ndesh me legjislacionin shqiptar në fuqi.

Per te gjithë aktivitetet per ushttrimin e te cilave kerkohet license e posacme, shoqeria do te ushtroje aktivitetin pasi me pare te jete pajisur me licensen perkatese nga organet kopetente.



Neni 4

Kapitali fillestar themelor i Shoqërisë "The Clinic" shpk do të jetë 10.000 lekë (një mijë) lekë, me kontributet e ortakeve:

Znj. Migena Qato, e cila zoteron 50% te kapitalit dhe Znj. Esta Kokla, e cila zoteron 50% tjetër te kapitalit.

Emri Mbiemri	Përqindja	Kuota	Kontributi në lekë
Znj. Migena Qato	50%	1	5.000 Leke
Znj. Esta Kokla	50%	1	5.000 Leke

Neni 5

Kapitali i shoqërisë mund të shtohet ose të pakesohet sipas vendimeve që do të marre ortaku. Në rast se kapitali i shoqërisë për shkak të humbjeve të vertetuara, në dokumentat financiare rezulton me i vogël se gjysma e kapitalit themeltar, ortaku vendos brenda tre muajve nga miratimi i llogarive të përcaktoje këto humbje mbi mundësinë e prishjes së parakoheshme të shoqërisë. Në rast se prishja nuk shpallet, shoqëria zvogëlon kapitalin e saj me një vlerë jo më të vogël se ajo e humbjeve që kanë mbetur, pa mbuluar fondet rezerve.

Neni 6

Ortaku i vetëm mund t'u shesë të tretëve kuota të kapitalit të tij, teresisht apo pjesërisht të shoqërisë, të cilët kanë të drejtën e parablerjes qofte edhe në kushte të barabarta. Kjo e drejtë duhet ushtruar brenda 30 ditëve nga data e komunikimit.

Neni 7

Organet drejtuese të shoqërisë janë :

- Ortaket
- Administratori



Afati i emerimit të administratorit është 5 vjet, me të drejtë riperseritje, në bazë të nenit 95 të Ligjit 9901, dt.14.04.2009, sic është përcaktuar në statut.

Procedura për emerimin në funksionet perkatese dhe shkarkimin e tij rregullohen sipas statutit të shoqërisë.

Neni 8

Administratori i shoqërisë emërohet **Esta Kokla**, Znj. Esta Kokla, e lindur në Gramsh, në datë 01.09.1998 dhe banuese në adresën: Tirane, -----, e identifikuar me ID nr. J85901023F, lëshuar në datë 04.01.2018, shtetase shqiptare. Afati i saj në shoqëri do të jetë 5 vjet.

Përveç sa është përcaktuar shprehimisht në statutin dhe aktin e themelimit të shoqërisë, Administratori do të ketë tagrin të kryejë veprime bankare në llogarinë e shoqërisë që lidhen me tërheqjen e shumave të depozituara apo çdo veprim tjetër, veprime të cilat mund të kryhen vetëm nga administratori apo persona të tjerë të autorizuar enkas me prokurë të posaçme për këtë qëllim. Administratori është gjithashtu i autorizuar të veprojë në emër të



Shoqërisë në formim e sipër deri në regjistrimin e saj pranë Qendrës Kombëtare të Regjistrimit. Ai është i autorizuar të firmosi të gjitha aktet dhe të marrë përsipër detyrime në emër të Shoqërisë që rrjedhin prej momentit të regjistrimit të saj si dhe ka të drejtë ti delegoj kompetencat e tij personave të tjerë.

Modalitetet për ndryshimin e administratorit si dhe kompetencat e tij rregullohen nga Statuti i shoqërisë, ligji 9901 datë 14.04.2008 " Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare" si dhe ligji Nr. 9723 datë 03.05.2007 "Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit.

Neni 9

Vendimet e ortakut të vetëm mund të merren edhe nëpërmjet konsultimit me shkrim.

Neni 10

Likuiditet dhe transaksionet financiare do të depozitohen në bankat shqiptare dhe në ato të huaja, nëse shoqëria do të ketë llogaritë e saj rrjedhese. Për kapitalin themeltar të shoqërisë është hapur libri i llogarive ku do të shenohet kontributi i ortakut të vetëm. Po kështu shoqëria ka dhe përdor dokumentacionin sipas kërkesave të ligjit për kontabilitetin e gjithë kërkesave të tjera financiare të domosdoshme për veprimtarinë normale të saj.

Neni 11

Fitimi neto i realizuar nga shoqëria i mbetet ortakëve në përpjestim me kontributin në kapitalin themeltar të shoqërisë, mbasi të jenë likuiduar të gjitha detyrimet, dhe të jenë hequr 5 % që do të futet në fondin e rezervës ligjore deri në përbushjen e 1/10 të kapitalit të shoqërisë.

Neni 12

Shoqëria fillon veprimtarinë e saj vetëm pasi të ketë marrë autorizimin e organeve kompetente sipas legjislacionit në fuqi.

Neni 13

Ortaku është i detyruar të ruajë karakterin sekret të dokumentacionit, të eksperiencës së shkëmbyer, të realizuar brenda veprimtarisë së shoqërisë.

Neni 14


Të gjitha mosmarreveshjet që nuk mund të zgjidhen me mirekuptim, do të paraqiten për zgjidhje në gjykatën kompetente shqiptare, në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Neni 15


Ky akt themelimi u përpilua në prani të ortakëve duke shprehur në të vullnetin e tyre të lirë. Akti i themelimit u përpilua në katër kopje me fuqi të barabarta secila, për t'u depozituar në organet kompetente, tatimore, në zyren e noterise, si dhe një kopje të ruhet në dokumentacionin bazë të shoqërisë.

ORTAKËT E SHOQËRISE ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR

Znj. **Migena Qato**



Znj. **Esta Kokla**



Tiranë, më 01 Shtator 2025